



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2022

VENDIM

Nr. 4, Datë 13.01.2022

PËR

**NDËRPRERJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM PËR
GJYQTARIN Z. {...}, PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, në vendimin nr. 261, datë 17.06.2021 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në vendimin nr. 597 datë 23.12.2021 “Ngritjen në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Vlorë, z. {...}” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në kushtet kur verifikohet që gjyqtari të jetë ngritur në detyrë dhe caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Apelit Vlorë, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Ndërprerjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 16.01.2022.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR